



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA EKONOMIKE

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, date 18/08/2026

"PËR MIRATIM RISHPERNDARJE FONDESH NDERMJET PROGRAMEVE NË BUXHETIN E

BASHKISË ROSKOVEC PËR VITIN 2026"

Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Per vetëqeverisjen vendore", neni 9, pika 1.2 germa b, neni 23 dhe neni 54 pika dh, te ligjit 68/2017 "Per financat e veteqeverisjen vendore" neni 45, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne RSH" i ndryshuar neni 44, paragrafi II, germa a, të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", vendimit të Këshillit të Bashkisë, te VKB nr. 71 datë 24.12.2025 "Për miratimin e dokumentit perfundimtar përfundimtar të PBA 2026-2028 dhe buxhetit të Bashkisë Roskovec dhe ndërmarrjes vartëse për vitin 2026" si dhe shkresa nr 4235/1 datë 20 07 2026. Për shpalljen fitues të projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit.

- Ju paraqesim për diskutim e miratim;

- I. Të miratohet rishperndarja e fondeve ndermjet programeve per objektet e investime dhe shpenzimeve per operative & mirembajtje ne buxhetin e vitit 2026 si me poshte vijone:

Shtohet:

N R	G R	TIT	K A P	A R T	EMERTIMI I PROGRAMIT BUXHETOR	EMERTIMI I OBJEKTIT/SHPENZIMIT	Njesia Shpenzuese	Vlera e plote e objektit /shpenzimit qe shtohet	2026	2027	2028
1	00	09120	5	231	Arsimi Baze parashkollor	Bashkefinancim i Rikostruksion I shkolles 9-vjecare Ali Sollaku+kopesht dhe I ambjenteve sportive vidhisht	Bashkia Roskovec	13,006,123	142,320	12,863,803	0

Pakesohet:

N R	G R	TIT	K A P	ART	EMERTIMI I PROGRAMI T BUXHETOR	EMERTIMI I OBJEKTIT/SHPENZIMI T	Njesia Shpenzuese	Vlera e plote e objektit /shpenzimit qe pakesohet	2026	2027
1.	00	04520	5	231	Rrjeti rrugor rural	Blerje materiale per rehabilitimin e rruges se Liqenit Roskovec per Projektin Qeverisje e mire permes pjesemarrjes aktive ne bashkefinancim e projekteve	Bashkia Roskovec	142,320	142,320	0
						SHUMA:		142,320	142,320	

I. Të miratohet shuma totale e investimit prej 86,707,487 (Tetëdhjetë e gjashtë milion e shtatëqind e shtatë mijë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë) me financim nga Ministria e Arsimit dhe Bashkefinancimi Bashkia Roskovec prej 13,006,123 (Trembëdhjetë milion e gjashtë mijë e njëqind e njëzetë e tre)

Qar ku	Bashkia	kodi	Emertimi i projektit	Vlera e plote	Fondet nga MAS	Kontributi nga NJQV	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
Fier	Roskovec	09120	Rikostruksion I shkolles 9-vjecare Ali Sollaku+kopesht dhe I ambjenteve sportive vidhisht	86,707,487	73,701,364	13,006,123	14,740,273	15,000,000	43,961,091

II. Ngarkohet Administrata e Bashkise per zbatimin e ketij vendimi.

Konceptoi: E.Toro

Konfirmoi: D.Hoxha

Per Drejtorine Juridike dhe te Burimeve Njerezore : V. Zeqo

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZËVENDESKRYETARI

Maksim Goga

KRYETAR
Majlinda BUFI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA EKONOMIKE

Nr. 6330/1 Prot.
Dt. 18.08.2026

Lenda: Relacion per Projekt-Vendimin "Për miratim rishperndarje fondesh ndermjet programeve në buxhetin e bashkisë Roskovec për vitin 2026"

KËSHILLIT BASHKIAK

Roskovec

Të nderuar anëtar/anëtare te KB !

Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Per vetëqeverisjen vendore", neni 9 , pika 1.2 germa b , neni 23 dhe neni 54 pika dh , te ligjit 68/2017 "Per financat e veteqeverisjen vendore" neni 45 , të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne RSH" i ndryshuar neni 44 , paragrafi II , germa a , të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomis nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", vendimit të Këshillit të Bashkisë , te VKB nr. 71 datë 24.12.2025 "Për miratimin e dokumentit perfundimtar perfundimtar të PBA 2026-2028 dhe buxhetit të Bashkisë Roskovec dhe ndërmarrjes vartëse për vitin 2026" si dhe shkresa nr.4235/1 datë 20.07.2026. Për shpalljen fitues te projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit.

Ju relatojme:

Në këtë projekt-vendim kemi përcaktuar përdorim të fondeve të ngelura nga prokurimet e zhvilluara për objektet e investimeve të planifikuara për vitin buxhetor 2026, është krijuar fonde i lirë nga lidhja e kontratave investime tjera.

Mendojmë përdorimin e fondit si më sipër në një objekte të ri investimi ,një shtesë në zërin rikostruksion i i shkollës 9-vjeçare Ali Sollaku + kopësht dhe i ambjenteve sportive Vidhisht .

Sipas projekt-vendimit bashkëlidhur bazuar në shkresa nr.4235/1 datë 20.07.2026. Për shpalljen fitues te projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit. :

1. Për këtë arsyeje do të jemi të detyruar që të bëjmë dhe ndryshimet përkatëse në PBA 2027-2029 , për pjesën e të pritshmit të vitit 2026 meqë janë dhe transferime ndërmjet programeve dhe që këto fonde ishin miratuar në buxhetin fillestar me financim për vitin 2026 , afati perfundimtar i të cilave është data 15 shtator 2026 , datë në te cilin dërgohet në Ministrinë e Financave dhe PBA e rishikuar.

Për sa më sipër, propozojmë miratimin e Projekt-Vendimit “Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve në buxhetin e bashkisë Roskovec për vitin 2026”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj!

Konc: E.Toro

Miratoi: D.Hoxha



KRYETAR
Majlinda Bufi

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZËVENDËSKRYETARI

Maksim Goga

